

VENDIM
Nr. 115, datë 10.6.2024

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “MALIDO - ENERGJI” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pika dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1052/3 prot., datë 7.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Malido - Energji’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Malido - Energji” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klos”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 78, datë 23.10.2009, dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 16.1.2012.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1052 prot., datë 8.4.2024, ajo ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1052/1 prot., datë 9.5.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit të saj.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar me shkresën nr. 1052/2 prot., datë 22.5.2024, ERE i evidentoi shoqërisë informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1052/3 prot., datë 30.5.2024, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria “Malido - Energji” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Malido - Energji” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Malido - Energji” sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “Malido- Energji” sh.p.k. bëhet “AG Hpower & Construction” sh.p.k.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Malido - Energji” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Malido -Energji” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti